


Tregtia e jashtme e mallrave

Shtator 2022

Tiranë, më 17 Tetor 2022: Në Shtator 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 39 mld lekë, duke u rritur me 16,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 9,5 %, në krahasim me Gusht 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 88 mld lekë, duke u rritur me 27,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 10,5 %, në krahasim me Gusht 2022. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 49 mld lekë, duke u rritur me 37,6 %, krahasuar me Shtator 2021 dhe me 11,3 %, në krahasim me Gusht 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë nëntëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 366 mld lekë, duke u rritur me 37,9 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 695 mld lekë, duke u rritur me 25,1 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 329 mld lekë, duke u rritur me 13,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shtator 2022, në rritjen e eksporteve prej 16,3 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: "Tekstile dhe këpucë" me +5,8 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me +5,2 pikë përqindje dhe "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +3,0 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me -1,3 pikë përqindje dhe "Lëkurë dhe artikuj prej tyre" me -0,01 pikë përqindje.

Për publikim 17/10/2022

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2022




Eksportet, gjatë këtij nëntëmujori janë rritur me 37,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +10,9 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 6,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Shtator 2022, në rritjen e importeve prej 27,4 %, krahasuar me Shtator 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +8,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,7 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,2 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2022



Si nëntëmujor, importet janë rritur me 25,1 %, krahasuar me nëntëmujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,8 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +3,5 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shtator 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2021 janë: Itali (16,8 %), Gjermani (110,5 %) dhe Maqedoni (30,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (24,8 %) ,Spanja (1,6 %) dhe Greqia (26,5 %).

Gjatë këtij nëntëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (45,0 %), Kosova (1,8 %) dhe Gjermania (79,2 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Spanja (15,4 %) .

Në muajin Shtator 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2021 janë: Italia (7,5 %), Turqia (102,4 %) dhe Greqia (32,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (21,6 %), Rusia (28,7 %) dhe SHBA (29,3 %).

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,4 %), Turqia (41,8 %) dhe Greqia (33,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (17,4 %), Rusia (19,6 %) dhe Zvicra (27,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2022



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 58,4 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,4 %), Turqia (10,7 %), Gjermania (8,3 %) dhe Greqia (7,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntëmujorin 2022, me vendet e BE-së zënë 59,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shtator 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,4 %), Turqia (8,4 %), Greqia (7,2 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Tab, 1 Qarkullimi i mallrave, Shtator 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	5,0	52	-14,2	-27	47,8
	Janar - Shtator 19	225	-2,8	481	3,1	-256	46,8
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	-1,2	52	-1,8	-27	48,2
	Janar - Shtator 20	195	-13,5	429	-10,9	-234	45,4
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	09 - 21	33	43,3	69	32,4	-36	48,0
	Janar - Shtator 21	266	36,5	556	29,6	-290	47,8
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	09 - 22	39	16,3	88	27,4	-49	43,8
	Janar - Shtator 22	366	37,9	695	25,1	-329	52,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shtator 2022

	Eksporte				Importe			
	Shtator 2021	Shtator 2022	Janar - Shtator 2021	Janar - Shtator 2022	Shtator 2021	Shtator 2022	Janar - Shtator 2021	Janar - Shtator 2022
Vendet e BE-së	24.181	29.673	190.690	269.537	36.246	44.220	302.381	362.242
Austri	254	277	1.849	3.818	563	568	4.996	5.147
Gjermani	1.733	3.647	14.532	26.046	4.267	6.827	40.428	43.776
Greqi	2.279	1.675	15.499	19.578	6.209	8.218	42.766	57.126
Itali	14.089	16.449	110.880	160.732	15.692	16.876	136.735	150.998
Spanjë	2.572	2.530	17.533	14.836	903	1.602	8.232	11.863
Kroaci	168	614	1.989	5.865	671	963	5.744	7.493
Të tjera të BE-së	3.087	4.480	28.408	38.661	7.941	9.166	63.479	85.838
Mbretëri e Bashkuar	111	129	617	1.550	443	580	4.491	5.696
Kinë	1.009	462	6.296	7.902	5.480	7.240	47.651	54.835
Kosovë	3.747	2.817	27.336	27.827	1.668	1.308	9.317	11.784
Maqedonia e Veriut	1.145	1.494	9.196	12.655	1.606	1.656	9.184	11.918
Rusi	-	-	8	25	1.550	1.106	10.550	8.481
SHBA	307	599	3.297	11.265	1.159	820	12.032	9.936
Turqi	281	567	4.235	4.808	6.384	12.923	59.785	84.804
Ukrainë	31	34	253	445	178	360	2.576	3.201
Zvicër	293	84	1.963	2.549	2.053	654	7.962	5.755
Të tjera	2.017	2.671	21.707	27.679	12.237	17.046	89.715	136.529
Gjithsej	33.121	38.531	265.600	366.241	69.004	87.912	555.647	695.181

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë). Shtator 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shtator 2021	Shtator 2022	Janar - Shtator 2021	Janar - Shtator 2022	Shtator 2021	Shtator 2022	Janar - Shtator 2021	Janar - Shtator 2022
Gjithsej	33.121	38.531	265.600	366.241	69.004	87.912	555.647	695.181
Ushqime, pije, duhan	3.487	3.861	31.725	36.586	11.601	14.060	94.117	113.420
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	6.212	7.918	50.973	80.505	11.730	15.683	58.506	118.836
Produkte kimike dhe plastike	967	1.272	7.551	13.896	9.141	9.836	82.164	86.956
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	207	205	1.496	2.109	1.322	1.343	10.613	12.762
Prodhime druri dhe letre	976	1.321	6.997	10.545	2.630	3.225	20.006	26.377
Tekstile dhe këpucë	9.852	11.764	81.955	99.508	8.388	9.415	64.080	74.363
Materiale ndërtimi dhe metale	8.059	7.623	56.354	85.293	8.869	14.956	77.463	103.879
Makinëri, pajisje dhe pj. këmb.	2.521	3.500	20.815	28.595	13.088	16.649	123.791	133.452
Të tjera	840	1.067	7.735	9.205	2.234	2.747	24.907	25.136

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Shtator 2022

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	110.880	160.732	27.336	27.827	14.532	26.046	15.499	19.578
Ushqim. pije duhan	7.969	8.158	3.368	4.045	1.155	1.256	2.757	2.916
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.318	17.477	6.358	4.087	4.005	15.155	5.332	3.016
Produkte kimike dhe plastike	2.150	3.630	2.289	3.133	52	47	557	2.940
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.307	1.926	14	12	36	10	10	29
Prodhome druri dhe letre	4.359	6.370	666	1.133	188	251	1.013	1.519
Tekstile dhe këpucë	64.266	77.818	130	135	5.511	6.071	3.675	4.322
Materiale ndërtimi dhe metale	15.622	26.362	12.287	12.733	1.632	944	1.688	4.113
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	10.329	14.660	1.124	1.390	1.643	1.951	69	107
Të tjera	3.561	4.332	1.100	1.159	311	361	399	617

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Shtator 2022

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	136.735	150.998	59.785	84.804	47.651	54.835	42.766	57.126
Ushqim. pije duhan	17.685	21.333	5.055	4.725	749	1.141	12.247	14.061
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	8.349	3.391	3.949	7.027	10	6	6.941	16.109
Produkte kimike dhe plastike	17.059	18.707	7.964	9.172	6.825	5.606	6.810	7.448
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.609	10.006	316	430	538	726	26	24
Prodhome druri dhe letre	4.569	5.616	2.504	4.525	537	916	2.979	3.614
Tekstile dhe këpucë	30.012	36.428	13.533	13.932	8.462	9.000	2.416	3.267
Materiale ndërtimi dhe metale	17.637	19.706	15.143	32.128	4.036	6.542	7.490	7.997
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	27.924	30.053	7.766	8.930	21.964	25.606	2.499	3.418
Të tjera	4.891	5.758	3.556	3.935	4.530	5.292	1.358	1.189

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri